

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të punës 03/L-212, si dhe UA Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nent 5,7,8, Statutit të Ndërmarrjes dhe rregullorëve të brendshme, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko- Llapi” Sh.A. Podujevë shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Mirëmbajtës/e i hapsirave të brendëshme (higjenist/e) - Njëmbëdhjetë (11) pozita

Titulli i Punës: Mirëmbajtës/e i hapsirave të brendëshme (higjenist/e)

Raportimi: Drejtuesit/es të njësisë operative

Njëmbëdhjetë (11) Pozita: Mirëmbajtës/e i hapsirave të brendëshme (higjenist/e)

Vendi i punës: NPL “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Orari i punës: 40 orë në javë

Niveli i pagës: 7

Periudha provuese: 6 muaj

Detyrat e përgjegjësitë:

- a) Është përgjegjës/e për realizimin e objektivave të caktuara nga Drejtuesi i Njësisë,
- b) Koordinon punët me punonjësit/et tjerë/a së bashku me përgjegjës/in e grupit në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me Njësinë ,
- c) Merr pjesë në mbledhjet e rregullta ku është i/e thirrur për nevojat e Njësisë,
- d) Është përgjegjës/e për pastrimin e njësive të caktuara nga Drejtuesi i Njësië,

- e) Mban evidencë të njësive të pastruara dhe e dorëzon këtë raport në baza javore te Drejtuesi i Njesisë,
- f) Për punët dhe detyrat e shtruara i përgjigjet Drejtuesit të Njesisë,
- g) Porositë për materiale i bën më herët dhe i specifikon në detaje sipas kërkesës,
- h) Materialet të cilat nuk furnizohen sipas kërkesës ka të drejtë t'i kthejë mbrapa,
- i) Kujdeset për mjetet e punës dhe raporton për defektet e tyre,
- j) Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar,
- k) Drejtuesi i Njesisë mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së Ndërmarrjes,
- l) Në rast mungese të punonjësve tjerë, me urdhër të Drejtuesit të Njesisë mund të zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera,
- m) Në bazë të nevojave dhe kërkesave, kujdeset për intervenime të ndryshme në këto hapësira,
- n) Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët.
- o) Detyra tjera relevante

Aftësitë

- Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë,
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me pastrim,
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë,
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në objekte të ndryshme,
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në të gjitha kushtet atmosferike,
- Të ketë etikë dhe integritet në punë.

Dokumentet e kërkuara :

- Aplikacioni i NPL;
- Dëshmitë për Shkollim - Shkolla Fillore ose e Mesme
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës)Nr.19-Kati I, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues. Dokumentacioni i mbyullur në zarf dorëzohet në NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti I Komunës) Nr.19-Kati I,

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të njoftohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës, pas mbylljes së konkursit

Sqarim:

Fillimi i punës për vendin e cekur më lartë, nuk do të jetë domosdoshmeri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit të këtij konkursi por në vartësi të nevojave të Ndërmarrjes.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet që para nënshkrimit të kontratës të sjellë çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike.

Shpallja është e hapur që nga data 26.04.2024 deri më 10.05.2024

NPL “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë

Kryeshf Ekzekutiv

